

BASHKIA FIER

NJOFTIM PER BOTIM PER DHENIE ME QERA

Ne zbatim te ligjit nr 139/2015 "Per veteqeverisje vendore", ne VKM nr.54 date 05.02.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontata te tjera te pasurise shteterore" I ndryshuar , ne VKB-ne nr 58 date 24.07.2017 "Per miratimin e dhenies me qira te lokalit pjese e objektit "Tregu produkteve bujqesore dhe blegtorale" :

Urdheron:

1. Fillimin e procedurave per dhenien me qira, me konkurim te prones ne Tregun e produkteve bujqesore dhe blegtorale me sip te pergjithshme 248.87m² ne pergjegjesi administrimi te Bashkise Fier.
2. Dhenia me qira e pasurise jepet me qellim per ambiente sherbimi (lokal) qe do te nxise rritjen e investimeve dhe hapjen e vendeve te reja te punes.
3. Vlera dysheme per detyrimin e qirase, per fillimin e prokurimit, eshte 150lek/m²
4. Afati I dhenies me qira te kesaj pasurie eshte 5 vjet.
5. Vleresimi I ofertave te konkurentëve do te behet me piket si vijon:

Niveli I nvestimit 10 pike

Niveli I punesimit 10 pike

Oferta e detyrimit mujor te qirase 80 pike

6. Konkurrimi do te zhvillohet ne daten 20.11.2017 ne oren 10:00 ne Bashkine Fier sipas procedurave te parashikuara ne VKM nr.54 date 05.02.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontata te tjera te pasurise shteterore" I ndryshuar.

7. Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira sipas legjislacionit në fuqi.

8. Konkurrentët do të paraqesin para komisionit, në datën dhe orën e caktuar, dokumentacionin si vijon:

a) Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të objektit.

b) Plan biznesin, i vulosur dhe i firmosur në çdo faqe, ku të përshkruhet qartë qëllimi i përdorimit, aktiviteti që do të zhvillohet, plani i investimeve, vlera e investimeve, zërat dhe fazat e zhvillimit të tyre, plani i punësimit, periudha e realizimit të tyre

c) Ofertën për detyrimin mujor të qirasë.

ç) Ekstraktin e regjistrimit të subjektit dhe ekstraktin historik të lëshuar nga QKB.

dh) NIPT-in e subjektit dhe vërtetim nga Dega e Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore.

e) Sigurim oferte ne vleren e qirase se nje muaji.

f) Vërtetim nga institucionet përkatëse se subjekti nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka proces gjyqësor që lidhet me veprimtarinë që ushtron.